REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 17.03.2025 Prot.34 (tridhjetëekatër)

Protokoll nr. 34

I mbajtur sot më datë 17.03.2025, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:
1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës)

2. P-V "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afat mesëm për periudhën 2026-2028 në nivel programi";

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari;Plator Çollaku;Ronaldo Skënderi; Idlir Limllari; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Eriseld Jonusllari; Petrit Kupe; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Ilia Xhuti; Klea Baçi; Neresida Shindo; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; 18(tetëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Floreta Zaçe; Rovena Terolli; Xhuana Hoxhallari; Aramando Dautllari; Server Xhuti; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Marjeta Xhelollari; Andonaq Risto; Dalina Krekas; Almir Elezi; Marainathi Avrami; 12 (dymbëedhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithve dhe faleminderit që ju përgjigjët thirjes për këtë mbledhje jashtë radhe, thirur nga Kryetari i Bashkisë si detyrim ligjor, mbështetur në ligjin për vetëqeverisjen vendore për diskutimin dhe miratimin e një pike, miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afat mesëm për periudhën 2026-2028 në nivel programi, i cili vjen si detyrim nga Ministria e Financave, që duhen të miratohen brenda 15 marsit, duke patur pushim festa dhe fundjava, na desh ta sillnim sot më datë 17 Mars.Bëjmë një verifikim të korumit, korumi realizohet, janë rreth 17-18 Këshilltarë në sallë, mund të vijojmë me mbledhjen dhe rendin e ditës, do kërkoja mirëkuptim tuaj, të miratojmë dhe Ndihmën Ekonomike nga fondi 6%, jemi të mbledhur dhe mos e pengojmë si proces.A jeni dakord me rendin e ditës? Duke shtuar dhe Ndihmën Ekonomike?

Kush është dakord ? 18 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 18 vota, Faleminderit! P-V "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afat mesëm për periudhën 2026-2028 në nivel programi"; Kush e do fjalën? Petrit.
Petrit Kupe: Si gjithmonë dhe ky P-V, është i ngjashëm me të tjerat, vendimmarja kërkohet nga Ministria e Financave për të parshikuar shpenzimet e vitit të ardhshëm, ky është një projekt i hataur nga specialistët e fianancës, ne nuk kemi ndonjë kundërshti për të mos e miratuar, besoj se dhe opozita do jetë dakord, që ky P-V të miratohet dhe të shkojë në instancat përaktëse.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Opozita?

Yllson Ibrahimllari: Faleminderit!Paraprakisht kishim dy gjëra, pati një tentativë për ta bërë mbledhjen online, për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afat mesëm për periudhën 2026-2028 në nivel programi, nga ana e Kryesisë.Ta konsutlojmë dhe me Kryetaren e Komisionit të Ligjeve, rregullorja e thotë qartë, ka disa mbledhje që nuk mund të bëhen online, ashtu si është kjo sot.Biem dakord për këtë pikë besoj ? Për sa i përket materialit që na kanë dërguar dhe detyrimt që ne si Këshill kemi për ta miratuar, sërisht ngelemi te ato që kemi diskutar në dhjetor për sa i përket projket buxhetit afat mesëm.Vetëm pagat janë në rritje çdo vit, ndose pak, por përbëjnë 60% të shpenzimeve, pra në 100 lekë 60 lekë, janë për anëtarët e partisë tuaj, apo ata të partisë tonë që i keni marrë dhe 40 lekë shkojnë për shpenzime dhe investime.Dhe spitalet e kanë më të ulët se 60% strukturën e pagave, kur morrëm përsipër për të përfaqësuar dhe duke ndjekur dhe diskursin politik të forcës që drejton këtë Këshill Bashkiak, ne do e votojmë Tvanet Buxhetore, do e shprehim si grup votën pro, nuk e pse bëjmë diskutime të tjera, por duhet të kemi parasysh këto objeksione që ju dhamë.Raporti është se çdo vit ky buxhet e varfëron më shumë dhe vazhdon thellon borxhin në këtë bashki, ne diskutohemi si bashkitë që vazhdojmë thellojmë borxhin për efekt të nivelit të pagave kjo ishte teknike.Tani ju i keni mundësitë ti aprovoni, por duhet të keni parsysh dhe këto objeksjone.Ju faleminderit !

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? Kryetar do shtosh diçka?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Unë dua të sqaroj atë Petriti tha në fillim, që ky është një detyrim ligjor për efekt të miratimit të Tavaneve Buxhetorë, nuk po marrim një vendim që është për efekt zbatimi, ajo deri në mirtaimin e buxheteve respektivë sipas viteve, ajo kërkon rialokim, ndryshim, shtim fondesh, por si detyrim ligjor ne ja çojmë Ministrisë të Financave dhe ata miratojnë Tavanet tona dhe Drejtoria përkatse e Financës në Bashki, fillon për llogaritjet për çdo vit buxhetor.Në lidhje me % që kap pjesa e pagave, me pjesën e shpenzimeve dhe të investimeve, vetëm një zë po të marr, pjesën e aparatit adminsitrativ ku është pjesa më e madhe, nga 354 milon lekë, 161 milon lekë i zenë shpenzimet operative dhe inevesimet në total, dmth gati 50% në shërbim ndaj komunitetit dhe po të shikojmë, në krahësim me bashki të tjera të cilat në

rrugët janë bërë të paklueshme, kam biseduar me ata që po bëjnë punimet dhe projekti nuk parashikon as 1 m kub çakëllim pas punimeve, duhet të zgjidhet.Faleminderit!

Server Xhuti:Për ujësjellsin e Zvezdës, Kryetari na tha në muajin Nëntor do përfundojë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ujësjellsi i Zvezdës, është në proces tenderimi, po bëhet vlersimi i firmave të shpresojmë të fillojë dita ditës.

Idlir Limllari: Dhe unë kisha diçka për pastrimet që bënë në Plasë dhe Zëmblak, doja tju përgëzoja, por kanë filluar njerzit hedhin përsëri mbeturina atje ku keni pastruar ju.Policia Bashkiake të vendosë gjoba, që të ndërgjegjsohen ose të vendosen tabela.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:I morra si shqetësime dhe patjetër që do i ndjek.Ujin në varrezat e Libonikut, rruga e Rovit, nuk ishte në gjendje që ne do dëshironim, e çakëlluar, mirë do ishte të ishte me asfalt, por jemi duke e parë.Rrjetin e ujit që tha Petriti e kemi problem në disa fshatra.

Albina Xhejo: Kur do jetë e mundur të bëhet ujësjellsi i fshatit Zvirinë? Ose të pastrohet çezmat e fshatit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kanë ardhur ekspertet dhe nuk po na jep rezultat, ne po shikojmë mundësinë të ndërpresim ujin që merr Vreshtasi dhe të furnizohet Zvirina, po gjejmë dhe dy zgjidhje të tjera një në Kopole që tani del jashtë funksonit, me ndërtimin e ujësjellist të ri të Podgories, do reabilitohet dhe depoja e Vreshtasit, do i japim ujë dhe nga Podgoria sepse uji është në sasi më të madhe.Pusi që pastruam në Zvirinë nuk na dha rezualtat, jemi duke diskutuar me ujësjellsin e Korçës për një zgjidhje.Për shqetësimin që u ngtit me ndërtimin e disa ujësjellsave që po bën ujësjellsi i Korçës dhe na ka prishur rrugët dhe rreshjet e ditëve të fundit ka krijuar një situatë jo normale, ne kemi rregaur menjëherë dhe ata janë duke marrë një zgjidhje.Plasë-Zëmblak do më vijë keq nëse hidhen mbetje, kemi bërë një investim shumë të madh, po mendojmë që rrugën anësore të Plasës ta ndriçojmë dhe të shkojmë drejt asfaltimit për ta kthyer në një zonë të bukur, do shikohet dhe nga ana jonë kjo problematikë.

Yllson Ibrahimllari:Në këtë pikë do shtoja dhe diçka, pas investimit që keni bërë duhet të bëni dhe një njoftim te mediat lokale për kundravajtjet administrative, besoj se do vlente në atë pjesë, sepse është goxha investim duhet rruajtur, një pronocim te Tv lokal i Korçës, njoftim për banorët e zonës, të cilët në bazë të nenit përaktës do marrin gjobë.Kam dhe diçka për sa i përket fshatit Mesmal pavarshisht popullsisë që është në reduktim, ata kanë probleme me ujësjellsin kërkojnë si markuça, është një terren i vështirë, ndoshta duhet parë mundësia te banderat që ka vetë Bordi i Kullimit, të cilat shpesh herë i keni përdorur në këtë formë.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Kemi dhe një qyetar që ka një problem.

Qyetari: Kam problemin e djalit që e kam invalid në shtëpi, ja kanë ndërperë ndihma ushqimore, nga Doraksi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Dorkasi nuk varet nga bashkia, por do e shohim si rast, nëse ke diçka me bashkinë na i thuaj, ja ku është Ermanda për ta zgjidhur.Dorkasi vepron vetë, ne i çojmë propozimet, për rastin në fjalë do e pyesim si qëndron, me shpresëta futin përsëri te paketa shtu si ka qenë.

Qyetari:nuk i njihet zonjës kujdestari si vite për pension?

Qarkun tonë, apo dhe në territorin e Shqipërisë, ndoshta jemi nga bashkitë më të mira për efekt të %, ndër vite të fondeve që ne kalojmë për investime kapitale në territori dhe kjo është e dukshme, po të shohim dhe faktin e realizimit, që ne çdo vit i prokurojmë fondet nga dy herë, për efekt të kursimit të fondeve buxhetore, që ndonjëherë shkojnë 30% dhe ndoshta mbi 30%, duke kryer punime dy-fish, do të thotë që pjesa që kap puna konkrete e bashkisë në investime është e konsiderueshme shkon e dhe mbi 30%, kështu që, unë falenderoj dhe oponencën që bën pjesa e opozitës, sepse duhet marë në konsideratë, që ne të jemi dhe më të përgjegjshëm dhe më konkret për efekt të fondeve, por faket flasin që ne kemi qenë të kujdeshëm në këtë pikë, por patjetër ka vend për rishkime, plotësime, për rregullime në çdo rast.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar!Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?
Kush është dakord ? 18 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 18 vota P-V Për Tavanet Buxhetore, Faleminderit! Kalojmë te P-V tjetër, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shkurt 2025"; Kush e do fjalën? Kemi diçka te kjo pikë? Kryetar ke diçka për të shtuar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nuk kam diçka, ato janë fonde, për ata që nuk kanë plotësuar pikët e mjaftueshme, besoj se kjo është e njohur nga i gjithë Këshilli, rast pas rasti.

Ornildi Demollari: Dakord! E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 18 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 18 vota.Miratohet.Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari:Për sa i përket listës 6%, ka një kallzim penal për këtë, ftoj gjithë Këshilltarët kur kanë një raport, le ti bashkangjiten atji procesi dhe nuk kemi punë sa herë nxiret dhe futet dikush në listë, apo dhe me kriteret, kush do mund të shkojë atje.Listën e kalon Komisioni, kemi znj.Kryetare dhe znj.Ermanda, ky është një proces.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Miratohet edhe -V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shkurt 2025"; Faleminderit! Këto kishim si pika për sot për këtë mbledhje jashtë radhe, nëse keni ju diçka jemi të lirë ta diskutojmë, nëse jo e përfundojmë këtu dhe ju uroj ditë të mbarë.Për mbledhjen e radhës do njoftoheni.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kjo ishte mbledhja!

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI